



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 613/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Vehbi Ramës – Kandidat për Asamble Komunale dega në Viti, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet si e pas afatshme ankesa e Vehbi Ramës – Kandidat për Asamble Komunale dega në Viti.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Vehbi Rama me datë 04.11.2013, në ora 21:10 në të cilën ka pretenduar se, pasi që kamë qenë në cilësinë e kandidatit për Asamble Komunale në Viti me datë 03.11.2013 gjatë numërimit të votave të njejtat mu janë vjedhur apo keqpërdorur, pasi që gjatë numërimit më mungojnë votat.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesës gjeti se:

ankesa është e pas afatshme

Me ankesën e parashtruar nga Vehbi Rama pretendohet se gjatë numërimit të votave të njejtat mu janë vjedhur apo keqpërdorur.

PZAP-i pasi shqyrtoi ankesën konstatoi se, ankesa është e pas afatshme pasi që, nga shkelja e supozuar ankesa nuk është dorëzuar në afatin e rregullt ligjorë deri më datë 04.11.2013 në ora 19:00, e njëjta është dorëzuar në ora 21:00 që nënkupton se është dorëzuar dy orë pas afatit andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 613/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*